

DIREKTIVA NR. 86/613/KEE, “MBI ZBATIMIN E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË TË BURRAVE E GRAVE QË MERREN ME NJË VEPRIMTARI, PËRFSHIRË BUJQËSINË, KU JANË TË VETËPUNËSUAR”, DHE “ MBI MBROJTJEN E GRAVE TË VETËPUNËSUARA GJATË SHTATZËNISË DHE AMËSISË”

11 dhjetor 1986

Këshilli i Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian, dhe në veçanti nenin 100 dhe 235 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik e Social,

Ndërkohë që në rezolutën e tij, të datës dymbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy, “Mbi nxitjen e mundësive të barabarta për gratë”, Këshilli miratoi objektivat e përgjithshme të propozimit të Komisionit që lidhen me një program të ri veprimi të Komunitetit, mbi nxitjen e mundësive të barabarta për gratë (1982 - 1985), dhe shprehu gatishmërinë për të zbatuar masat përkatëse për arritjen e këtyre objektive;

Ndërkohë që veprimi 5 i programit të lartpërmendur, lidhet me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për gratë e vetëpunësuar dhe për ato të punësuar në bujqësi;

Ndërkohë që zbatimi i parimit të pagës së barabartë për burrat e gratë, të përcaktuar në nenin 119 të Traktatit, përbën një pjesë integrale të krijimit dhe funksionimit të tregut të përbashkët;

Ndërkohë që, në dhjetë shkurt njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë, Këshilli miratoi Direktivën 75/117/KEE “Mbi përafrimin e legjislacionit të shteteve anëtare që lidhen me zbatimin e parimit të pagës së barabartë për burrat e gratë”;

Ndërkohë që, në lidhje me aspektet e tjera të barazisë së trajtimit të burrave e grave, në nëntë shkurt njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë, Këshilli miratoi Direktivën 76/207/KEE “Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave përsa i takon të drejtës për punësim, formimit profesional dhe ngritjes në detyrë, si dhe kushteve të punës” dhe, në nëntëmbëdhjetë dhjetor njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë, miratoi Direktivën 79/7/KEE “Mbi zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështjet e sigurimeve shoqërore”;

Ndërkohë që, në lidhje me personat e vetëpunësuar në një aktivitet ku janë përfshirë dhe bashkëshortët e tyre, zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë duhet të

arrihet përmes hartimit të masave të hollësishme, të përcaktuara posaçërisht për të trajtuar situatën e veçantë të këtyre personave;

Ndërkohë që legjislacioni i shteteve anëtare në këtë fushë ka ndryshime, dhe duke qenë se, rrjedhimisht, është e nevojshme të përafrohen dispozitat kombëtare që lidhen me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë;

Ndërkohë që, në disa aspekte Traktati nuk ofron kompetencat e nevojshme për të ndër marrë veprimet e kërkuara përkatëse;

Ndërkohë që zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë nuk cenon masat në lidhje me mbrojtjen e grave gjatë shtatzënisë dhe amësisë,

Ka miratuar këtë Direktivë:

SEKSIONI 1

Qëllimet dhe fusha e veprimit

Neni 1

Qëllimi i kësaj Direktive është të sigurojë, në përputhje me dispozitat e mëposhtme, zbatimin në shtetet anëtare të parimit të trajtimit të barabartë mes burrave e grave të vetëpunësuar në një aktivitet, ose që kontribuojnë në një aktivitet të tillë, në lidhje me ato aspekte që nuk mbulohen nga Direktivat 76/207/EEC dhe 79/7/EEC.

Neni 2

Kjo Direktivë zbatohet për:

1. Punëtorët e vetëpunësuar, pra për të gjithë personat që kryejnë një aktivitet fitimprurës për llogari të tyre, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar, përfshirë fermerët dhe anëtarët e profesioneve të lira;

2. Bashkëshortët e tyre, që nuk janë të punësuar ose partnerë në aktivitet, në ato raste ku ata zakonisht, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar, marrin pjesë në aktivitetet e punëtorit të vetëpunësuar dhe kryejnë detyra të njëjta ose ndihmëse.

Neni 3

Për qëllimet e kësaj Direktive, parimi i trajtimit të barabartë nënkupton mungesën e çfarëdolloj diskriminimi për shkak të seksit, qoftë drejtpërdrejt ose jo, duke iu referuar në mënyrë të veçantë gjendjes civile ose familjare.

SEKSIONI II

Trajtimi i barabartë ndërmjet punëtorëve të vetëpunësuar burra dhe gra, pozicioni i bashkëshortëve pa statusin profesional të punëtorit të vetëpunësuar, mbrojtja e punëtorëve të vetëpunësuar dhe grave të tyre gjatë shtatzënisë dhe amësisë.

Neni 4

Në lidhje me personat e vetëpunësuar, shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të shfuqizuar të gjitha dispozitat që janë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë të përcaktuar në Direktivën 76/207/EEC, sidomos përsa i takon themelimit, pajisjes apo zgjerimit të një biznesi, ose fillimit apo zgjerimit të çfarëdolloj forme tjetër të një aktiviteti vetëpunësues, përfshirë lehtësitë financiare.

Neni 5

Pa cenuar kushtet specifike për pjesëmarrje në aktivitete të caktuara, te cilat zbatohen në mënyrë të barabartë për të dyja gjinitë, shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme që të sigurojnë se kushtet për krijimin e një kompanie nga bashkëshortët nuk do të jenë më shtrënguese se kushtet për krijimin e një kompanie nga persona të pamartuar.

Neni 6

Në rastet ku në një shtet anëtar ekziston një sistem kontributor i sigurimeve shoqërore për punëtorët e vetëpunësuar, shteti anëtar do të marrë masat e nevojshme për t'i mundësuar bashkëshortëve të përmendur në nenin 2 b, dhe që nuk janë të mbrojtur nga skema e sigurimeve shoqërore të punëtorëve të vetëpunësuar, që të marrin pjesë vullnetarisht në një skemë kontributore të sigurimeve shoqërore.

Neni 7

Shtetet anëtare do të marrin përsipër të shqyrtojnë se në çfarë kushtesh mund të nxitet njohja e punës së bashkëshortëve të përmendur në nenin 2b, dhe, në varësi të këtij shqyrtimi, të marrin parasysh hapat e nevojshëm për të nxitur këtë njohje.

Neni 8

Shtetet anëtare do të marrin përsipër të shqyrtojnë nëse, dhe në cilat raste, femrat e vetëpunësuar dhe gratë e punëtorëve të vetëpunësuar, gjatë ndërprerjeve të aktivitetit të tyre të punës për shkak të shtatzënisë ose amësisë:

- mund të përfitojnë nga shërbimet sociale kombëtare ekzistuese apo nga shërbime të tjera të përkohshme sociale, ose
- mund të kenë të drejtën për përfitime financiare sipas një skeme sigurimesh shoqërore ose sipas çfarëdo sistemi publik të mbrojtjes sociale.

SEKSIONI III

Dispozita të përgjithshme dhe përfundimtare

Neni 9

Shtetet anëtare do të përfshijnë në sistemet e tyre ligjore kombëtare të gjitha masat e nevojshme për tu mundësuar të gjithë personave, që e konsiderojnë veten padrejtësisht të përjashtuar nga zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në aktivitetet vetëpunësues, që të kërkojnë pretendimet e tyre edhe nëpërmjet procesit gjyqësor, mundësisht pas ankimit pranë autoriteteve të tjera kompetente.

Neni 10

Shtetet anëtare do të sigurojnë që masat e miratuara në zbatim të kësaj Direktive, së bashku me dispozitat përkatëse që janë miratuar që më parë, do t'ju bëhen të ditura organizmave që përfaqësojnë punëtorët e vetëpunësuar dhe qendrave të formimit profesional.

Neni 11

Këshilli do ta rishikojë këtë Direktivë, sipas një propozimi nga Komisioni, përpara datës një korrik njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre.

Neni 12

1. Shtetet anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive, jo më vonë se data tridhjetë qershor njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë.

Megjithatë, nëse një shtet anëtar i cili, në mënyrë që të përputhë legjislacionin e tij me nenin 5 të kësaj Direktive, do të duhet të ndryshojë legjislacionin e vet për të drejtat dhe detyrimet martesore, data në të cilin ky shtet anëtar duhet të veprojë në përputhje me nenin 5, do të jetë data tridhjetë qershor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një.

2. Shtetet anëtare do të informojnë menjëherë Komisionin për masat e marra për zbatimin e kësaj Direktive.

Neni 13

Shtetet anëtare do t'i dorëzojnë komisionit, jo më vonë se data tridhjetë qershor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një, të gjithë informacionin e duhur për të mundësuar hartimin dhe paraqitjen pranë Këshillit, te një raport mbi zbatimin e kësaj Direktive.

Neni 14

Kjo Direktivë i adresohet të gjitha shteteve anëtare.